



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.677/14 prot.

Datë 30.04.2026

V E N D I M

Nr. 577/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 467/2026, datë 03.04.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: “Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 12,000,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 16-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

Ankimues: Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me me NUIS L12121023B dhe adresë: Rruga “Robert Shvarc”, godina “Niku Constraksiun”, kati nr.1 teknik, hyrja nr.2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlore.
Sheshi “4 Heronjte”, Vlorë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 467/2026, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e prokurimit me nr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: “Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 12,000,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 16-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 3. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet dhe sqarimet e dokumentave të tenderit në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Në datën 21.04.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 677/9 prot., shkresa e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, datë 09.04.2026 me objekt: “Njoftohet KPP për veprimet e AK (Bashkia Vlorë) për vijimin e procedurës së prokurimit publik, pa hequr më parë nga pezullimi me vendim të KPP”, ku thuhet shprehimisht se:

“Në mbështetje të neneve 109 e në vijim, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimi publik”, të ndryshuar, si dhe nenet 94 e në vijim, të vendimit nr.285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreatx SHPK është ankuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për DST e publikuara nga AK Bashkia Vlorë, për procedurën e prokurimit publik me REF-76930-02-20-2026, me objekt “Implementimi i sistemit të ri dixhital të taksave dhe tarifave vendore”, me fond limit 12 000 000 (Dymbëdhjetë milion) Lekë. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit administrativ, KPP ka nxjerrë vendimin nr.467/2026, me të cilin ka pranuar ankesën e Kreatx SHPK, duke ngarkuar AK me detyrimin për të proceduar me hartimin dhe publikimin e shtojcës për modifikimin e DST. Gjithashtu, AK është ngarkuar me detyrimin që t’ja përcjellë më parë shtojcën e modifikimeve të DST KPP, me qëllim që ky i fundit të verifikojë nëse janë zbatuar urdhërimet e organit publik apeluar apo jo. Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik, KPP pasi njihet me veprimet e AK, vendos më pas heqjen ose jo nga pezullimi të procedurës së prokurimit publik. Vlen të sjellim në vëmendjen tuaj se, AK nuk ka vepruar sipas rregullave

të prokurimit publik, pasi në datën 17.04.2026 ka publikuar në SPE shtojcat për modifikimin e DST dhe ka vijuar me heqjen e procedurës nga pezullimi pa pritur më parë vendimin e KPP, duke hapur procedurën për pranimin e ofertave deri më datë 24.04.2026, ora 10:00. Në rrethanat kur procedura e prokurimit vijon pa pritur më parë vendimin e KPP për heqjen nga pezullimi, i lutemi KPP që të procedojë me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të garantuar mbarëvajtjen e procedurës së prokurimit publik në përputhje me LPP dhe RRPP.” E njëjta shkresë e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar përsëri në KPP në datën 22.04.2026, me nr.677/10 prot.

I.3.Me shkresën nr.6817/1 prot., datë 17.04.2026, me objekt: “Informacion lidhur me zbatimin e vendimit të KPP-së, për procedurën me nr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: “Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”, protokolluar me tonën nr. 677/11 prot., datë 23.04.2026, autoriteti kontraktor bën me dije Komisionin e Prokurimit Publik se: “[...] Bashkia ka reflektuar gjithë ndryshimet e parashikuara dhe ka publikuar shtojcën me ndryshime sipas përmbajtjes së vendimit të KPP”, bashkëngjitur shtojca me ndryshimet e DT-ve.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Në datën 21.04.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 677/9 prot., shkresa e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, datë 09.04.2026 me objekt: “Njoftohet KPP për veprimet e AK (Bashkia Vlorë) për vijimin e procedurës së prokurimit publik, pa hequr më parë nga pezullimi me vendim të KPP”, ku thuhet shprehimisht se:

“Në mbështetje të neneve 109 e në vijim, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimi publik”, të ndryshuar, si dhe nenet 94 e në vijim, të vendimit nr.285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreatx SHPK është ankuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për DST e publikuara nga AK Bashkia Vlorë, për procedurën e prokurimit publik me REF-76930-02-20-2026, me objekt “Implementimi i sistemit të ri dixhital të taksave dhe tarifave vendore”, me fond limit 12 000 000 (Dymbëdhjetë milion) Lekë. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit administrativ, KPP ka nxjerrë vendimin nr.467/2026, me të cilin ka pranuar ankesën e Kreatx SHPK, duke ngarkuar AK me detyrimin për të proceduar me hartimin dhe publikimin e shtojcës për modifikimin e DST. Gjithashtu, AK është ngarkuar me detyrimin që t`ja përcjellë më parë shtojcën e modifikimeve të DST KPP, me qëllim që ky i fundit të verifikojë nëse janë zbatuar urdhërimet e organit publik apelues apo jo. Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik, KPP pasi njihet me veprimet e AK, vendos më pas heqjen ose jo nga pezullimi të procedurës së prokurimit publik.

Vlen të sjellim në vëmendjen tuaj se, AK nuk ka vepruar sipas rregullave të prokurimit publik, pasi në datën 17.04.2026 ka publikuar në SPE shtojcat për modifikimin e DST dhe ka vijuar me heqjen e procedurës nga pezullimi pa pritur më parë vendimin e KPP, duke hapur procedurën për pranimin e ofertave deri më datë 24.04.2026, ora 10:00. Në rrethanat kur procedura e prokurimit vijon pa pritur më parë vendimin e KPP për heqjen nga pezullimi, i

lutemi KPP që të procedojë me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të garantuar mbarëvajtjen e procedurës së prokurimit publik në përputhje me LPP dhe RRPP.”

E njëjta shkresë e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar përsëri në KPP në datën 22.04.2026, me nr.677/10 prot.

II.2.Me shkresën nr.6817/1 prot., datë 17.04.2026, me objekt: “*Informacion lidhur me zbatimin e vendimit të KPP-së, për procedurën me nr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: “Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”,* protokolluar me tonën nr. 677/11 prot., datë 23.04.2026, autoriteti kontraktor bën me dije Komisionin e Prokurimit Publik se: “[...] *Bashkia ka reflektuar gjithë ndryshimet e parashikuara dhe ka publikuar shtojcën me ndryshime sipas përmbajtjes së vendimit të KPP”, bashkëngjitur shtojca me ndryshimet e DT-ve.*

II.3. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.467/2026, datë 03.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcat në SPE mbi ndryshimet dhe sqarimet lidhur me dokumentat e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin Nr.467/2026, datë 03.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Referuar parashtrimeve të shoqërisë ankimuese “Kreatx” SHPK si më sipër cituar, KPP konstaton se procedura në fjalë vazhdon të jetë e pezulluar në SPE.

Në pikën 2.5 të Udhëzimit nr.1, datë 03.06.2025 të Agjencisë së Prokurimit Publik thuhet shprehimisht se:

“2.5 “Pezullimi i një procedure prokurimi në sistem”

Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, me marrjen e ankesës nga ankimuesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga KPP, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP. Në rast se, ankesa rezulton e publikuar Titullari i AK urdhëron pezullimin e procedurës deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP. Procesi i pezullimit teknikisht në sistem, bëhet vetëm për procedurat e prokurimit që janë në pritje të ofertave, deri në datën dhe orën e përcaktuar si “Afati i fundit për pranimin e ofertave” dhe “Data e zhvillimit të tenderit”. Në rast se, AK duhet të pezullojë një procedurë prokurimi, pasi është bërë hapja e ofertave teknikisht në sistem nuk kryhet asnjë veprim. Në këtë rast, me daljen e urdhrit të Titullarit të AK për pezullimin e procedurës, nuk duhet të vijohet me zhvillimin e procedurës (pra nga anëtarët e KVO dhe anëtarët e njësisë së prokurimit nuk duhet të bëhet asnjë veprim në sistem), deri në momentin e heqjes së urdhrit të pezullimit nga Titullari i AK.”

Në nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit”, të LPP-së, parashikohet se:

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë

sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar. 3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”

Për sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të veprojë në përputhje me nenin 75 të LPP-së dhe udhëzimin e APP-së si më sipër cituar.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: “Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 12,000,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 16-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

